



Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat

PPSE - Kosovë

Plani vjetor operativ për vitin 2019

Përmbajtja

Lista e shkurtesave	3
1. Informatat themelore	5
2. Përmbledhja ekzekutive.....	6
3. Plani i veprimit janar - dhjetor 2019	7
3.1 Rezultati 1: Gratë e reja dhe minoritetet përfitojnë nga punësimi fitimprurës dhe gjithëpërfshirës, i krijuar në NVM-të dinamike në sektorët në rritje	8
3.2. Rezultati 2: NVM-të përmirësojnë ofertën, efikasitetin dhe konkurrueshmërinë e tyre në sisteme gjithëpërfshirës të tregut të cilat janë të përmirësuara dhe më të organizuara	12
3.3 Të arriturat tjera.....	18
3.3.1 Fondi i mundësive	18
3.3.2 Fondi për përfshirjen sociale.....	18
4. Temat transversale	19
5. Konsulenca	Error! Bookmark not defined.
6. Financat.....	Error! Bookmark not defined.
6.1 Buxheti	Error! Bookmark not defined.
7. Organizimi i projektit, menaxhimi dhe drejtimi.....	Error! Bookmark not defined.
7.1. Punëtoritë MSD dhe shkëmbimet	Error! Bookmark not defined.
7.2. Organizimi dhe menaxhimi i projektit	Error! Bookmark not defined.
7.2.1. Drejtimi i projektit.....	Error! Bookmark not defined.
7.2.2. Monitorimi dhe matja e rezultateve.....	20
7.3 Komunikimi	21

Lista e shkurtesave

B2B	Biznes me Biznes (ang. Business to Business)
B2C	Biznes me Konsumatorë (ang. Business to Consumer)
BEAM	Ndërtimi i tregjeve efektive dhe të qasshme
BMO	Organizatë e anëtarësimit të biznesit
CHF	Franga zvicerane
DCED	Komiteti i donatorëve për zhvillimin e ndërmarrjeve
DMO	Organizatë për menaxhimin e destinacionit
ENE	Ekonomia dhe punësimi
EYE	Rritja e punësimit të të rinjve
FAMtrip	Udhëtime të familjarizimit
FTE	Punësim me orar të plotë
FNI	Ushqimi dhe përbërësit natyral
GAP	Praktikat e mira bujqësore
HACCP	Analiza e Rrezikut dhe Pika e Kontrollit Kritik (ang. Hazard Analysis and Critical Control Point)
HO	Zyra qendrore
HoReCa	Hotelet, restorantet dhe kafiteritë
IFC	Standard i njohur
ISO	Standard i njohur
KIESA	Agjencia Kosovare e Investimeve dhe Përkrahjes së Ndërmarrjeve
KMC	Klubi i Prodhuesve të Kosovës
MAP	Bimët medicinale aromatike
MRM	Monitorimi dhe matja e rezultateve
MSD	Zhvillimi i sistemit të tregut
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
NTO	Organizata Kombëtare e Turizmit
OC	Rezultat
OF	Fondi i mundësive
PPSE	Promovimi i punësimit në sektorin privat
RAE	Romë, Ashkali and Egjiptian
SC	Komitet drejtues
SDC	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SEC	Trupat e ekspertëve seniorë

SIF	Fondi për përfshirjen sociale
SHKF	Shoqata e prodhuesve të frutave
SHTIB	Shoqatë e shitësve të lëndës së parë
SME	Ndërmarrje e vogël dhe e mesme
SRP	Paneli për shqyrtimin strategjik
ToR	Termet e referencës
YPO	Plani vjetor i veprimit

1. Informatat themelore

Shteti: Kosovë	Emri i projektit: Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat (PPSE)
SDC No SAP:	
Fusha e strategjisë së bashkëpunimit: ENE	

Synimi	NVM-të që veprojnë në sektorët ekonomikë të mirë-organizuar dhe përfshirës, që sigurojnë rritje të punësimit të qëndrueshëm për gratë dhe burrat e rinj në Kosovë.
Rezultatet (OC)	<p>Rezultati 1: NVM-të e sektorëve të përzgjedhur rrisin produktivitetin e tyre dhe gjenerojnë të ardhura shtesë dhe punësim.</p> <p>Rezultati 2: NVM-të përmirësojnë ofertën, efikasitetin dhe konkurrueshmërinë e tyre në sisteme gjithëpërfshirës të tregut të cilat janë të përmirësuara dhe më të organizuara.</p>

Kohëzgjatja e fazës së projektit: 16.11.2017-15.11.2021	Periudha e raportimit: 01.01.2019-31.12.2019
--	---

Buxheti në këtë fazë (CHF) – 7,276,126.50	Buxheti nga 01.01.2019 31.12. 2019 (CHF) – 1,938,430
Buxheti i shpenzuar në këtë fazë (CHF) ¹	
Informacion mbi kontributet e partnerëve dhe/ose donatorëve të tjerë (llogaritur në CHF) 100% SDC	

Organizatat zbatuese:	Swisscontact-i dhe Instituti Riinvest
Partnerët kryesorë kombëtarë: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Odat Ekonomike, firmat kryesore	Partnerët kryesorë ndërkombëtarë: n/a

Koordinatori e projektit	Argjentina Grazhdani	Numri i stafit të projektit	16
		Konsulentët (ditë): ²	40
		Konsulentët kombëtarë (ditë):	32
		Riinvest (ditë):	48
		Swisscontact (ditë)	48

¹ PPSE-ja ka shpenzuar mbi 90% të buxhetit vjetor për vitin 2018. Shifrat e sakta do të sigurohen sapo të merren informacione nga zyra qendrore e Swisscontact-it.

² Konsulencia të tjera ndërkombëtare dhe lokale janë planifikuar përmes buxhetit të pjesës 4 lidhur me vlerësimet dhe intervenimet tek tre rezultatet e PPSE-së (Shih shtojcën III).

2. Përmbledhja ekzekutive

Në vitin 2019, fokusi i PPSE-së vazhdon të jetë nxjerrja e përfitimeve nga intervenimet që kanë potencial të gjenerimit të punësimit. Ndërhyrjet e zbatuara në vitin 2018 tashmë kanë prodhuar rezultate të rëndësishme drejt këtij qëllimi: PPSE-ja ka arritur rreth 20% ose më shumë të pothuajse të gjitha objektivave. Intervenimet e qëndrueshme me potencial zgjerimi mbesin shtylla kryesore të strategjisë së PPSE-së. Intervenimet në vitin 2019 do të kontribuojnë në arritjen e objektivave të PPSE-së dhe do të sjellin ndryshime sistemike në sektorët e përbërësve ushqimorë dhe natyral dhe në sektorët e turizmit, me synime specifike vjetore të gjenerimit të punësimit fitimprurës (500 FTE; Punësim me orar të plotë, ang. Full Time Employment) dhe gjenerimin e të ardhurave përmes ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM-ve) tek të dy sektorët.

Në vitin 2018, ndërhyrjet në sektorin e ushqimit dhe përbërësve natyral (së këndeji FNI; ang. FNI Food and Natural Ingredients) kanë prodhuar rezultate të rëndësishme për punësim dhe gjenerim të të ardhurave. Për vitin 2019, ekipi planifikon të vazhdojë me një strategji të ngjashme sektoriale, me përmirësime të bazuara nga mësimet e nxjerra. Ndërhyrjet në sektor janë planifikuar të ndikojnë në të gjithë zinxhirin e vlerës. Nga perspektiva e inputeve dhe rezultateve, tre intervenime shënjestrojnë kufizimet në nivel të inputeve. Ndërhyrjet në nivel të inputeve janë: krijimi i prodhimit të fidanëve të specializuara për sektorin e perimeve, përmirësimin e shërbimeve të informacionit dhe shërbimeve këshillimore dhe zgjerimi i bujqësisë së kontraktuar për perime, bimë medicinale aromatike (së këndeji MAP; ang. Medicinal Aromatic Plants) dhe fruta të veçanta. Në nivelin e përpunimit, PPSE-ja planifikon të vazhdojë të mbështesë NVM-të me zhvillimin e produkteve, trajnimin e teknologjisë ushqimore dhe rritjen e kapaciteteve përpunuese. Për të shfrytëzuar më tej mundësitë rreth tregut të eksportit, do të lehtësohen shërbimet rreth certifikimit, panairëve ndërkombëtare si dhe misioni i shitësve/blerësve do të lehtësohet. Sa i përket promovimit të tregut të brendshëm, PPSE-ja do të lehtësojë shërbimet e tregut të përshtatura për NVM-të që ofrojnë produkte dhe shërbime të reja, si dhe aktivitete promovuese për tregun lokal. Së fundi, do të hulumtohen tema rreth organizimit të sektorit, siç janë skemat e subvencionimit të qeverisë për bujqësinë.

Në sektorin e turizmit, intervenimet e planifikuara synojnë kufizimet dhe mundësitë në nivelet e ofertës dhe kërkesës. PPSE-ja do të vazhdojë të mbështesë zhvillimin e produkteve të reja turistike në komunat e Pejës, Prishtinës dhe Prizrenit. Për më tepër, ekipi ka planifikuar aktivitete rreth përmirësimit të ofertës për agroturizëm. Numri në rritje i turistëve ka rritur kërkesën për udhëzime turistike. Prandaj, PPSE-ja do të mbështesë trajnimet afatshkurtëra për udhëzuesit e turizmit. Në nivelin e kërkesës, PPSE-ja shfrytëzon një strategji rreth segmenteve të tregut turistik me objektivin kryesor të rritjes së numrit të turistëve, kohëzgjatjen e qëndrimit dhe nivelet e shpenzimeve. Ndërhyrjet dhe aktivitetet specifike janë të dizajnuara rreth segmenteve të tregut, siç janë gjermano-folësit, turistët turq, vendorët, diaspora etj. Ndërsa në nivelin e organizimit të sektorit, PPSE-ja do të ndjekë zhvillimet dhe rezultatet e mbështetjes që u ofrohen komunave të Prishtinës dhe Prizrenit. Në përgjithësi, sektori i turizmit pritet të prodhojë rezultate më të larta në vitin 2019, duke marrë parasysh gjithashtu vonesën kohore në mes të zbatimit në vitin 2018 dhe rezultateve në këtë sektor.

Fondi i mundësive (së këndeji OF ang. Opportunity Fund) si një instrument do të integrohet në të dy sektorët. Në vitin 2019, fokusi i investimeve të OF-së do të jetë në sektorin e turizmit për të përmirësuar produktet turistike, për dallim nga viti 2018, ku të gjitha projektet ishin për sektorin e ushqimit. PPSE-ja do të përdorë fondin e mundësive dhe fondin për përfshirjen sociale (së këndeji SIF ang. Social Inclusion Fund) për të arritur tek bizneset dhe projektet të cilat janë më të rrezikuara dhe më të cenueshme.

Në përgjithësi, plani për vitin 2019 është një plan që synon më shumë të arritura dhe rezultate. Qasja e përqendruar e PPSE-së dhe intervenimet e synuara pritet të sjellin ndryshime pozitive, sistimore dhe të qëndrueshme për të dy sektorët. Detajet e aktiviteteve dhe planeve janë elaboruar në të gjithë dokumentin si dhe në anekse.

3. Plani i veprimit janar - dhjetor 2019

Ndikimi

NDIKIMI: NVM-të që operojnë në sektorë ekonomikë të mirëorganizuar dhe përfshirës, sigurojnë një rritje të punësimit fitimprurës dhe të qëndrueshëm për gratë dhe burrat e rinj në Kosovë	Treguesi i ndikimit	Vlerësimi bazë ³ 2017	Targeti për këtë fazë	% komulative e arritur në këtë fazë	2019 (T=Targeti)
	Ndikimi: FTE të punësimit shtesë neto	850 FTE	2000 FTE	18%	T= 500 FTE
	Punësimi shtesë neto (gratë) FTEs	270 FTE	600 FTE	25%	T= 150 FTE
	Punësimi shtesë neto (minoritetet) FTEs	75 FTE	200 FTE	25%	T= 50 FTE
	Ndikimi 1.2 Rritja neto shtesë e të ardhurave CHF	CHF 2,000,000	CHF 3,800,000	20%	T= CHF 950,000

Në vitin 2019, qëllimi i PPSE-së është të vazhdojë promovimin e punësimit gjithëpërfshirës dhe fitimprurës për gratë dhe burrat në Kosovë. Intervenimet e PPSE-së tashmë kanë prodhuar rezultate të rëndësishme gjatë vitit 2018. Ekipi ka mbledhur rezultatet e fundit nga intervenimet kryesore, megjithatë rezultatet e sakta dhe të vlefshme do të prezantohen dhe raportohen në raportin vjetor të PPSE-së për vitin 2018. Rezultatet preliminare tregojnë se në vitin 2018, intervenimet e PPSE-së kanë gjeneruar rreth 350 vende pune ekuivalent me orar të plotë (së këndejmi FTE; ang. full-time equivalent jobs FTE), 300 vende pune brenda sektorit FNI dhe 50 vende pune brenda sektorit të turizmit, me pothuajse 1,000 persona të cilët kanë përfituar nga punësimi. Synimet vjetore për gjenerimin e punësimit të grave dhe grupeve minoritare janë përmbushur, me rreth 150 gra FTE dhe 50 gra minoritare FTE të gjeneruara në të dy sektorët. Rreth 100 NVM kanë raportuar rritje neto shtesë të të ardhurave prej 760,000 franga zvicerane.

Për vitin 2019, PPSE-ja synon rezultate të ngjashme, me përpjekje më të mëdha për të arritur rezultate më të larta të punësimit në të dy sektorët. Veçanërisht për sektorin e turizmit, ndërhyrjet pritet të prodhojnë rezultate më të larta në vitin 2019, duke marrë parasysh vonesën kohore ndërmjet zbatimit dhe rezultateve të intervenimeve gjatë vitit 2018.

³ Bazuar në arritjet e fazës së I-rë

3.1 Rezultati 1: Gratë e reja dhe minoritetet përfitojnë nga punësimi fitimprurës dhe gjithëpërfshirës, i krijuar në NVM-të dinamike në sektorët në rritje

Rezultati 1: Të rinjtë, gratë dhe minoritetet përfitojnë nga punësimi fitimprurës dhe gjithëpërfshirës, i krijuar në NVM-të dinamike në sektorët në rritje	Treguesi i rezultatit	Vlerësimi bazë 2017	Targeti për këtë fazë	% komulative e arritur në këtë fazë	2019 (T=Targeti)
	OC 1.1 Numri i grave dhe burrave të punësuar me paga	0	5,000	20%	1,250
	Numri i grave dhe burrave të punësuar me paga	0	1,500	30%	375
	Numri i grave dhe burrave të punësuar me paga (minoritetet)	0	500	35%	125
	OC 1.2 Rritja e të ardhurave për 5,000 gra dhe burra përmes pagës/të hyrave	0	CHF 9,600,000	12%	CHF 2,400,000

Nën kuadër të rezultatit 1, PPSE-ja do të mbështesë intervenimet me potencial të gjenerimit të punësimit, duke synuar rritjen e NVM-ve në sektorin e FNI-së dhe në sektorin e turizmit. Intervenimet në kuadër të kësaj arritje **synon përmirësimin e ofertës si në sektorin e FNI-së ashtu edhe në sektorin e turizmit**. Në mënyrë të veçantë për sektorin e FNI-së, PPSE-ja do të punojë për **përmirësimin të produkteve dhe shërbimeve të NVM-ve**, përmirësimin të **kapaciteteve të tyre të përpunimit dhe zgjerimit të sistemit të bujqësisë kontraktuese**. Në sektorin e turizmit, përmirësimi i ofertës turistike duhet të vihet në shënjestër **duke mbështetur prezantimin e produkteve dhe atraksioneve të reja turistike**, si dhe për mundësitë rreth **promovimit të agroturizmit**.

Rezultatet e fundit tregojnë se ndërhyrjet në kuadër të këtij rezultati kanë kontribuar në përmbushjen e pothuajse të gjitha caqeve vjetore. Rezultatet preliminare tregojnë se numri i grave dhe burrave të punësuar me pagë (dominuar nga puna sezonale) në të dy sektorët tejkalon numrin e 1,000 të punësuarve. Ndërsa caqet vjetore për përfshirjen e grave dhe pakicave janë tejkaluar, me mbi 450 gra dhe mbi 170 pjesëtarë nga pakicat (duke përfshirë këtu mbi 95 pjesëtarë nga grupet RAE) kanë përfituar nga punësimi. Ekipi do të vazhdojë të bëjë përpjekje të mëdha në zbatimin e intervenimeve për të rritur më tej gjenerimin e punësimit dhe fitimet në të dy sektorët në vitin 2019. Detajet e intervenimeve dhe aktiviteteve që do të çojnë në rezultate janë paraqitur në detaje tek pjesa e të arriturave respektive.

Rezultati 1.1 NVM-të kanë përmirësuar cilësinë dhe shumëllojshmërinë e produkteve dhe shërbimeve.

Rezultati 1.1 NVM-të kanë përmirësuar cilësinë dhe shumëllojshmërinë e produkteve dhe shërbimeve.	Treguesi i rezultatit	Vlerësimi bazë 2017	Targeti për këtë fazë	% komulative e arritur në këtë fazë	2019 (T=Targeti)
	OP 1.1.1 Numri i produkteve dhe shërbimeve të reja dhe të përmirësuara të promovuara përmes NVM-ve	0	150	21%	38
	OP 1.1.2 Vlera shtesë e investimeve për produktet dhe shërbimet e reja	0	CHF 5,000,000	17%	1,250,000
	OP 1.1.3 Numri i NVM-ve që ofrojnë produkte dhe shërbime të reja dhe të përmirësuara	0	100	17%	25

Sektori i ushqimit dhe përbërësve natyral

Në kuadër të sektorit të ushqimit dhe përbërësve natyral (FNI), projekti do të vazhdojë të **mbështesë NVM-të për të përmirësuar gamën e produkteve dhe shërbimeve**, si dhe **rritjen e investimeve**. Në vitin 2018, PPSE-ja ka përfunduar aktivitetet e intervenimit, të cilat kanë mundësuar **shkëmbimin e njohurive dhe ekspozimin e** informacionit për zhvillimin e produkteve të reja. Shtatëmbëdhjetë NVM kanë përfituar përmes platformës 'Trajnimi për rritje' (ang. Coaching for Growth) në bashkëpunim me CEED-në në Kosovë. Këto NVM pritet të prezantojnë së shpejti produkte të reja dhe të përmirësojnë produktet ekzistuese. PPSE-ja gjithashtu ka punuar drejtpërdrejt me 7 NVM përmes misionëve të SEC (së këndejmi SEC - Trupat e ekspertëve seniorë; ang. Senior experts corps) dhe shërbimeve të këshillimit për rritjen e biznesit në fushën e prezantimit të produkteve të reja, përmirësimit të shitjeve dhe shërbimeve të marketingut dhe investimeve.

Për ta plotësuar sektorin e ndërhyrjeve, projekti ka përdorur fondin e mundësive për të mbështetur NVM-të në teknologji të reja për prodhimin dhe zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve të reja. Së bashku, përmes këtij rezultati, PPSE-ja synon të nxisë rritjen e biznesit dhe të forcojë konkurrueshmërinë e produkteve dhe shërbimeve të Kosovës në sektorin e përpunimit të ushqimit.

Në vitin 2019, PPSE-ja synon të ndërtoj mbi bazën e rezultateve të arritura, ku 'të diplomuarit' e intervenimit të quajtur 'Trajnim për rritje' do të lansojnë produkte të reja në treg. PPSE-ja do të mbështesë më tej këta dhe "inovatorë" të tjerë me ekspertizë specifike në shërbimet e teknologjisë ushqimore, trajnime për marketing dhe zhvillim të produkteve, si dhe bashkëfinancim për përmirësimin e teknologjisë. Përmes intervenimeve dhe aktiviteteve në kuadër të këtij rezultati, sektori FIN synon të **ndihmojë 25 produkte dhe shërbime të reja/të përmirësuara të ofruara nga të paktën 15 NVM; investime shtesë (përfshirë instrumentet e OF-së dhe SIF-it).**

1. Trajnim për rritje: Projekti do të lehtësojë shërbimet lidhur me trajnimet individuale për zhvillimin e produkteve dhe marketingut, si dhe organizimin e vizitave studimore rajonale ose ndërkombëtare. Ky trajnim do t'i ofrohet një grupi të përpunuesve ushqimorë, të cilët do të përzgjidhen nga një grup i "të diplomuarve" nga trajnimi i quajtur "Trajnim për rritje" dhe "inovatorëve" të rinj potencial.

Partnerët e mundshëm për këtë intervenim mund të përfshijnë **ofruesit e shërbimeve të specializuara ose konsulentët individualë (p.sh. Recura, CEED, BCC)**. Ekspertiza specifike për përpunuesit e ushqimit sipas nevojës së tyre në produkte dhe shërbime do të trajtohet edhe përmes **misioneve të SEC**. Ky intervenim pritet të çojë drejtpërdrejt në **krijimin e produkteve të reja dhe të përmirësuara** për sektorin e ushqimit, **rritjen e shitjeve nga ana e përpunuesve vendas** dhe në mënyrë indirekte çon në **rritjen e investimeve dhe punësimin**.

- Lehtësimi i shërbimeve të teknologjisë ushqimore:** Mungesa e ekspertizës në teknologjinë ushqimore vazhdon të jetë një pengesë e madhe për përpunuesit e ushqimit në Kosovë. Pas përpjekjeve të dështuara për të bashkëpunuar me qendrën BUTGEM në Turqi, PPSE-ja ka identifikuar një partner tjetër potencial në Bullgari - **Universitetin e Teknologjisë Ushqimore në Plovdiv**, i cili mund të ofrojë trajnime afatshkurtëra të përshtatura për teknologjinë ushqimore. Ky entitet tashmë është duke mbështetur programe të ngjashme në vendet e Ballkanit. PPSE-ja synon të mbështesë një **trajnim afatshkurtër për stafin e teknologjisë ushqimore të NVM-ve**. Kjo është planifikuar të zbatohet në bashkëpunim me **CEED në Kosovë**, e cila do të organizojë një grup të NVM-ve (duke përfshirë të diplomuarit e trajnimit të quajtur "Trajnim për rritje") të gatshëm për të bashkë-financuar trajnime të teknologjisë ushqimore për stafin e tyre.
- Përmes intervenimit të quajtur "**Linjat e specializuara të prodhimit**", projekti synon të bashkë-financojë linjat e specializuara të prodhimit për përpunuesit ushqimor. Për të prezantuar linjat e specializuara të prodhimit, projekti do të **mbështesë investimet në teknologjitë e reja (të plotësuar me OF-në)**. Një shembull i suksesshëm është mbështetja e ofruar për PNK-në përmes fondit të mundësive, meqë rast kompania ka përmirësuar të gjitha objektet e prodhimit dhe ka investuar në një linjë të re prodhimi. Ky intervenim është nxitur nga një mundësi e evidentuar dhe pritet të çojë drejt produkteve të reja dhe të përmirësuara, të rrisë kultivimin e kontraktuar, investimet shtesë dhe të rrisë shitjet dhe të ardhurat për NVM-të. Përmes kësaj ndërhyrje PPSE-ja do të synojë kompanitë më të vogla përpunuese, të cilat nuk do të kërkojnë investime të mëdha që do t'u mundësojnë atyre të specializohen në produkte specifike (partnerët e mundshëm përfitues janë: Herbakos, Genci, Vicianum, Sweet Pop etj).

Sektori i turizmit

PPSE-ja do të lehtësojë intervenimet dhe aktivitetet për përmirësimin **dhe prezantimin e produkteve dhe shërbimeve të reja turistike**, duke synuar tregjet e segmentuara siç janë (diaspora, turistët rajonalë dhe lokalë). Në vitin 2018, janë zhvilluar katër produkte të reja turistike në Prizren, duke përfshirë këtu: paragliding, kajak, kamping luksoz (ang. glamping) dhe çiklizëm. Këto produkte pritet jenë në treg në pranverë të vitit 2019. PPSE-ja ka ofruar mbështetje teknike për Komunën e Prishtinës, për zhvillimin e modelit të menaxhimit të muzeut dhe planifikimin e tre muzeve të rinj.

Në vitin 2019, fokusi do të mbetet në Prizren dhe Prishtinë për zhvillimin e produkteve dhe atraksioneve turistike. Ekipi do të kërkojë gjithashtu mundësi në rajonin e Pejës. Ekipi do të shqyrtojë mundësinë të punojë në turizmin rural dhe zhvillimin e pakove turistike, përmirësimin e ofertës rreth turizmit në fushën e kulinarisë dhe turneve. Në tërësi, PPSE-ja synon të ndihmojë zhvillimin e **15 produkteve të reja/të përmirësuara turistike** me së paku **10 NVM**, duke gjeneruar investime private prej mbi **400,000 franga zvicerane**.

- Siç u përmend më lart, në kuadër të intervenimit "**Zhvillimi i produktit të turizmit**", ekipi do të vazhdojë të kërkojë mundësi për bashkëpunim me sektorin privat për investim në produkte të turizmit rreth qytetit të Prishtinës, Prizrenit dhe Pejës. Rajoni i Zhupës (Recan, Mushnikovë dhe Prevallë) ka treguar potencial në aspektin e rritjes së turizmit, ardhjes së turistëve dhe gatishmërisë së sektorit privat për të investuar. Ekipi aktualisht është duke punuar me partnerët e sektorit privat për të zhvilluar pesë produkte të reja siç janë: **kopshti botanik në Badocv, kampingu në Pejë, dhoma e arratisjes në Prishtinë, zip-Line dhe via-ferrata në Prizren**, të cilat pritet të zhvillohen në fillim të vitit 2019. Në Prishtinë, ekipi synon të lansojë një thirrje për

propozim me qëllim të bashkëfinancimit të investimeve në produktet e turizmit nga ana e sektorit privat. Qëllimi i intervenimit është rritja e numrit të turistëve, kohëzgjatja e qëndrimit dhe nivelet e shpenzimeve nga diaspora, turistët lokalë dhe rajonalë.

2. Sa i përket intervenimit të quajtur "**Atraksione turistike**", ekipi do të ndjekë nga afër zbatimin në lidhje me **zhvillimin e tre muzeve** nga ana e Komunës së Prishtinës,. Mbështetje teknike do të merret parasysh për Komunën e Prizrenit, e cila e ka ndarë buxhetin për hapjen e **muzeut Filigran dhe muzeun Nënë Tereza**.
3. PPSE-ja synon të pilotojë një ndërhyrje për përmirësimin e **ofertës në fushën e kulinarisë tek restorantet rurale** përmes mbështetjes së restoranteve në përmirësimin e ofertës së tyre (recetave), si dhe **përmirësimin e lidhjeve të furnizimit me fermerët përreth**. Mundësitë do të kërkohen rreth qytetit të **Prizrenit, Pejës, Prishtinës dhe Rahovecit (për turne në verari)**.

Të arriturat 1.2: NVM-të kanë rritur prodhimin	Treguesi i të arriturave	Vlerësimi bazë 2017	Targeti për këtë fazë	% komulative e arritur në këtë fazë	2019 (T=Targeti)
	OP 1.2.1 Numri i fermave dhe NVM-ve të përfshira në bujqësi kontraktuese	350 SME	1,000 SME	32%	250 SME
	OP 1.2.2 Rritja e prodhimit të kontraktuar	200 ha	500 ha	70%	125 ha

Të arriturat 1.2: NVM-të kanë rritur prodhimin.

Përmes këtij rezultati, PPSE-ja do të vazhdojë të mbështesë zgjerimin e **bujqësisë kontraktuese për nën-sektorin e perimeve, produkteve pyjore jo-drusore dhe frutave**. Në vitin 2018, intervenimet e zbatuara nga PPSE-ja kërkonin rritjen e prodhimit primar për industrinë e përpunimit dhe të eksportit, si dhe rritjen e kapaciteteve mbledhëse dhe përpunuese. PPSE-ja ka arritur në rreth **225 fermerë të tjerë** të cilët janë përfshirë në bujqësinë kontraktuese dhe janë kultivuar **363 hektarë** shtesë për të përmbushur nevojat kontraktuale nga ana e nëntë partnerëve që merren me përpunim, qendrave mbledhëse dhe eksportuesve.

Në vitin 2019, PPSE-ja do të zgjerojë më tej intervenimin me **kulturat ekzistuese me vlerë të shtuar** (p.sh. kultivimin e NWFPS) dhe potencialisht do të përfshijë kultura të reja, fermerë dhe partnerë të rinj. Sa i përket nën-sektorëve, theks më i veçantë do t'i kushtohet **MAP-ve dhe frutave të buta**, ndërsa sa i përket perimeve, fokusi do të jetë në **rritjen e prodhimit në rajone të reja**, ndërsa në **rajonet ekzistuese fokus do të jetë rritja e produktivitetit**. Mbështetje do t'u ofrohet prodhuesve ekzistues të specializuar të fidanëve për përmirësimin e teknologjisë së prodhimit. Për më tepër, do të hulumtohen mundësitë për të lidhur prodhimin primar me kanalet e reja të shitjeve (p.sh. Hotelet, restorantet dhe kafiteritë, së këndejmi HoReCa; ang. Hotels, restaurants and cafes) të cilat lidhen me turizmin. Shembuj të tillë mund të jenë promovimi i konceptit të ushqimit të ngadaltë dhe agroturizmit, të cilat paraqesin potencial në tërheqjen e numrit më të madh të turistëve vendas, diasporës dhe turistët rajonalë. Intervenimet në këtë output synojnë të **arrijnë objektivin e 250 fermave që kultivojnë 125 ha nëpërmjet bujqësisë së kontraktuar**.

1. Intervenimi i quajtur "**Forcimi i sistemit të bujqësisë kontraktuese**" do të zgjerohet më tej nga viti i parë, pasi ai ka dëshmuar se është shumë i suksesshëm dhe ka sjellë numrin më të madh të punësuarve në vitin e parë. **Fermerëve ekzistues** do t'i sigurohet përkrahje për të **rritur produktivitetin** (p.sh. në makineri, qasje në fidane të specializuara, etj). **Për fermerët e rinj**, përkrahja do t'u ofrohet kontraktorëve (p.sh. qendrat e grumbullimit, përpunuesit) për të **rritur kapacitetet për agregimin ose procesimin** e më shumë prodhimeve primare (p.sh. makineritë e

tharjes) si dhe do t'i mundësojë shërbime këtyre fermerëve të rinj, **me programe të trajnimit dhe arritjeve**. Fokus i veçantë do t'i kushtohet **sektorit të MAP-së**, në rritjen e kapaciteteve të qendrave të reja grumbulluese në rajone të reja, duke mobilizuar kështu fermerët e rinj në afërsi. **Kultivimi i MAP-vë organike** ka dëshmuar të jetë i suksesshëm për fermat e vogla dhe familjet (tipike për kontekstin e Kosovës) me një kërkesë gjithnjë në rritje për eksport.

- Në vitin 2018, PPSE-ja përmes fondit të mundësive dhe intervenimeve ka mbështetur **"Prezantimin e prodhuesve të farërave/fidaneve të specializuara"** për perimet dhe MAP-të. Projekti do të vazhdojë punën me prodhuesit e fidanëve për të **rritur më tej kapacitetet dhe njohuritë e tyre**. Qëllimi i këtij intervenimi është rritja e cilësisë së fidanëve të prodhuara në Kosovë si hap i parë drejt rritjes së produktivitetit në nivel ferme. Për më tepër, PPSE-ja do të bëjë përpjekje të prezantojë **fidane të prodhuara nga fidanishtet brenda sistemit të bujqësisë së kontraktuar**. Blerja e fidaneve nga fidanishtet mund të jetë një kosto fillestare shtesë për fermerët, që supozohet të shpaguehet me cilësi më të lartë të produktit dhe rendimentit. Për të motivuar fermerët e kontraktuar për blerjen e fidanëve nga fidanishtet, PPSE-ja planifikon të zbatojë një model të zvogëluar të subvencionimit (duke mbështetur shpenzimet e fidanëve me 50% në vitin e parë dhe 20% në vitin e dytë). Shfrytëzimi i fidanëve/farërave të prodhuara në mënyrë profesionale pritet të rrisë produktivitetin në prodhimin e perimeve me të paktën 30%.⁴

3.2. Rezultati 2: NVM-të përmirësojnë ofertën, efikasitetin dhe konkurrueshmërinë e tyre në sisteme gjithëpërfshirës të tregut të cilat janë të përmirësuara dhe më të organizuara

Rezultati 2: NVM-të përmirësojnë ofertën, efikasitetin dhe konkurrueshmërinë e tyre në sisteme gjithëpërfshirës të tregut të cilat janë të përmirësuara dhe më të organizuara	Treguesi i rezultatit	Vlerësimi bazë 2017	Targeti për këtë fazë	% komulative e arritur në këtë fazë	2019 (T=Targeti)
	OC 2.1 Numri i NVM-ve që përfitojnë nga përdorimi i shërbimeve të reja ose të përmirësuara mbështetëse	0	150 SMEs	23%	38 SMEs
	OC 2.2 Rritja shtesë neto e të ardhurave e 150 NVM-ve	0	CHF 3,800,000	20%	CHF 950,000
	OC 2.3 Institucionet janë më të përgjegjshme për rritjen e sektorit privat	0	Vlerësimi cilësor bazuar në diskutimet në grupe të fokusuar të personelit kryesor të institucionit		

PPSE-ja do të vazhdojë të lehtësojë përmirësimin e ofrimit të shërbimeve nga ana e bizneseve, gasjen në kanalet e shitjeve, organizimin dhe rrjetëzimin në sektorin e turizmit dhe të FNI-së. Në vitin 2018, në kuadër të sektorit të FNI-së, ekipi ka mbështetur shërbimet e certifikimit për NVM-të, pjesëmarrje të drejtë në treg dhe lidhje tregtare nëpërmjet misionit të shitësve dhe blerësve. Fokus i lidhjeve me shërbimet mbështetëse në sektorin e turizmit ka qenë kryesisht për trajnime joformale, ndërsa për sa i përket promovimit – është ofruar mbështetje e gjerë për pjesëmarrje të drejtë, është bërë organizimi i udhëtimeve të familjarizimit dhe gazetarëve, si dhe është bërë promovimi i targetuar. Rezultate të rëndësishme janë shënuar edhe në të dy sektorët sa i përket organizimit të sektorit dhe rrjetëzimit. Rreth 35 NVM kanë përfituar drejtpërsëdrejti nga shërbimet e mbështetura nga PPSE-ja, ndërsa përfitimi neto shtesë i të ardhurave të NVM-ve si rezultat i të gjitha intervenimeve të PPSE-së në vitin 2018 tejkalon shifrën e 760,000 franga zvicerane.

⁴ Vëzhgim dhe vlerësim joformal me akterët dhe ekspertët e sektorit.

Në vitin 2019, PPSE-ja do të **intensifikojë intervenimet dhe aktivitetet** brenda këtij rezultati, duke i dhënë përparësi një qasjeje më të orientuar drejt rezultateve. Brenda sektorit FNI-së, mbështetje do të vazhdojë t'i kushtohet shërbimit të tillë siç është **certifikimi që mundëson rritjen e eksporteve**, ndërsa është planifikuar fokus shtesë për mbështetjen e shërbimeve të marketingut të përshtatura për NVM-të si dhe përmirësimin e shërbimit të informacionit dhe shërbimet këshilluese për fermerët. Sa i përket qasjes në treg, përkrahja për panairë tregtare do të vazhdojë me pjesëmarrja në panairë tregtare dhe lidhjet e drejtpërdrejta tregtare (përmes misionëve të shitjes), ndërsa përpjekje shtesë do t'i jepet zbatimit të aktiviteteve rreth **promovimit lokal**. Në sektorin e turizmit, ekipi do t'i japë përparësi aktiviteteve për rritjen e **qasjes dhe rrjedhjes së turistëve rreth segmenteve të identifikuar**. Aktivitete specifike promovuese do të zbatohen në bazë të këtyre segmenteve të tregut. Sa i përket organizimit të sektorit dhe rrjetëzimit, ekipi do të monitorojë dhe ndjekë intervenimet e suksesshme në turizëm dhe do të zbatojë aktivitete të mëtejshme rreth **temave për menaxhimin e mbeturinave**.

Detajet e intervenimeve dhe aktiviteteve që do të çojnë në rezultate janë paraqitur në detaje në rezultatet përkatëse.

Të arriturat 2.1: Ofruesit e shërbimeve ofrojnë shërbime biznesore të përmirësuara

Të arriturat 2.1: Ofruesit e shërbimeve ofrojnë shërbime biznesore të përmirësuara	Treguesi i të arriturave	Vlerësimi bazë 2017	Targeti për këtë fazë	% komulative e arritur në këtë fazë	2019 (T=Targeti)
	OP 2.1.1 Numri i NVM-ve që përdorin shërbime të reja dhe të përmirësuara të ofruara nga ofruesit e shërbimeve	0	300	21%	75

Sektori i ushqimit dhe përbërësve natyral

Në kuadër të këtij rezultati PPSE-ja do të vazhdojë të mbështesë bizneset rreth certifikimit të standardeve të sigurisë ushqimore dhe cilësisë, marketingut dhe informacionit. Në vitin 2018, PPSE-ja ndihmoi shërbimet e certifikimit organik dhe global GAP për 30 ndërmarrje të vogla dhe të mesme përmes shoqatave përkatëse të sektorit. Mbështetja është siguruar për certifikimin dhe shërbimet e subvencionimit të kostos brenda shoqatave për të përgatitur NVM-të për certifikim. Shërbimet e certifikimit për prodhime organike janë ofruar nga Albinspekt nga Shqipëria, ndërsa një ofrues vendor i shërbimeve - GAP Plus ka ofruar shërbime të certifikimit Global - GAP.

Në vitin 2019, PPSE-ja synon të vazhdojë mbështetjen për programet e certifikimit duke ulur kontributin e PPSE-së për NVM-të e certifikuar tashmë. Certifikimi ka dëshmuar të jetë çelës për zhbllokimin e qasjes në tregun e eksportit për NVM-të, prandaj **qëndrueshmëria e këtij intervenimi** lidhet me kanalet e eksportit për këto NVM. Sa i përket shërbimeve të marketingut, PPSE-ja do të shqyrtojë mundësitë **për të mbështetur NVM-të të cilat lansojnë produkte të reja** (rezultati 1.1) **me shërbimet e marketingut**. Një pilot projekt është iniciuar në dhjetor të vitit 2018, meqë rast një NVM është lidhur me një agjenci marketingu për emërtimin dhe dizajnimin e produkteve të reja. Kah fundi i vitit 2018, PPSE-ja, gjithashtu ka filluar të bëjë një intervenim me shoqatën e shitësve të lëndës së parë, me qëllim të **përmirësimit të shërbimeve të informatave, shërbimeve këshilluese dhe shërbimeve të farmacive bujqësore**.

1. Intervenimi i quajtur **"Lehtësimi i programeve të certifikimit"**, do të vazhdojë të zbatohet për të mbështetur më tej NVM-të për të pasur qasje në mundësitë e tregut të eksportit. Ky intervenim është i lidhur edhe me rezultatin 2.2. Qëllimi i intervenimeve është që të **mbështesë programet e certifikimit të cilat hapin potencial për eksport për NVM-të**. Partneriteti me ORGANIKA do të vazhdojë për mbështetjen e NVM-ve për certifikim organik, ndërsa ekipi do të vlerësojë

partneritetet më të mira të mbështetjes për programet e tjera të certifikimit siç është certifikimi Global GAP. Modalitetet e mbështetjes do të përfshijnë **subvencionet e kostos (duke reduktuar pjesën mbështetëse për NVM-të tashmë të certifikuara) dhe shërbimet e zbatimit të certifikimit.**

- Nëpërmjet intervenimit të quajtur **"Lehtësimi i shërbimeve të marketingut"**, PPSE-ja ka për qëllim të promovojë **qasjen dhe përdorimin e shërbimeve të marketingut siç janë brendimi, dizajnimi, promovimi, marketingu inteligjent dhe plane marketingu.** Këto shërbime konsiderohen të kenë një ndikim të drejtpërdrejtë në performancën e NVM-ve në treg dhe pritet të **kontribuojnë drejt rritjes së përgjithshme të shitjeve dhe rritjes së biznesit.** PPSE-ja tashmë ka organizuar një takim me një grup të agjencive të marketingut, me qëllim të shqyrtimit të mundësive për ofrimin e shërbimeve të përshtatura të fizibilitetit dhe marketingut për përpunuesit e vegjël dhe të mesëm ushqimor, meqë rast një marrëveshje ndërmjet një agjencie marketingu dhe një NVM-je është nënshkruar tashmë. PPSE-ja planifikon të bashkë-financojë koston e shërbimeve të marketingut për NVM-të. Intervenimi është nxitur nga mundësitë e evidentuara dhe pritet të përmirësojë marketingun e NVM-ve me rastin e lansimit të produkteve të reja - të lidhura me rezultatin 1.1.
- Intervenimi i quajtur **"Shërbimet e përmirësuara të informacionit (shërbimet këshillëdhënëse)"** është duke u zbatuar në partneritet me shoqatën e shitësve të lëndës së parë (së këndejmë SHTIB; ang. the Association of Input Dealers) që nga shtatori i vitit 2018. Intervenimi ka për qëllim të përmirësojë sistemin dhe cilësinë e ofrimit të informacionit nga farmacitë bujqësore tek fermerët. Aktivitetet në kuadër të këtij intervenimi përfshijnë **një vlerësim bazë të rezultateve bujqësore dhe shpërndarjen e informacionit në Kosovë, shkëmbim vizitash për të mësuar për praktikat më të mira rajonale, trajnimet për farmacitë bujqësore dhe tryeza të rrumbullakëta për tema që lidhen me këtë sektor.** Mbështetja dhe/ose ngritja e mëtejshme e këtij intervenimi synon të përmirësojë shërbimet e informacionit dhe do të planifikohet pas përfundimit dhe vlerësimit të intervenimit.

Sektori i turizmit

Në kuadër të këtij rezultati, PPSE-je mbështet NVM-të turistike me **trajtime afatshkurtëra joformale për profesione të kërkuara specifike.** Në vitin 2018, PPSE-ja ka ndihmuar me trajtime afatshkurtëra më shumë se pesëdhjetë individë në profesione specifike të kërkuara nga tregu, siç janë: udhëzues/guida të qytetit, udhëzues malorë dhe kamerierë. Në vitin 2019, PPSE-ja do të vazhdojë të mbështesë trajtime të ngjashme afatshkurtëra bazuar në kërkesën e tregut.

- Në kuadër të intervenimit të quajtur **"Profesione të specializuara të turizmit"**, ekipi tashmë ka identifikuar dy trajtime joformale për t'i mbështetur. Më saktësisht, trajnimi i parë do të organizohet për rreth njëzet individë të cilët do të **trajnohen si udhëzues të qytetit - folës të gjuhës frënge,** ndërsa trajnimi i dytë ka të bëjë me **udhëzuesit/guidat malor në Kosovën Perëndimore.** Mbështetje të tjera ad-hoc do të merren parasysh me prioritet për trajnimin e udhëzuesve/guidave (kulturore, natyrore, turneve të qytetit dhe aventurave) për shkak të mundësive të tregut. Qëllimi i këtij intervenimi është përmirësimi i ofertës turistike të Kosovës, veçanërisht si përgjigje ndaj rritjes së kërkesës për ta vizituar vendin.

Të arriturat 2.2: NVM-të kanë përmirësuar qasjen në kanalet e shitjes

Të arriturat 2.2: NVM-të kanë përmirësuar qasjen në kanalet e shitjes	Treguesi i të arriturave	Vlerësimi bazë 2017	Targeti për këtë fazë	% komulative e arritur në këtë fazë	2019 (T=Targeti)
	OP 2.2.1 Numri i NVM-ve që përdorin kanale të reja dhe të përmirësuara të shitjeve		0	300	15%

	OP 2.1.2 Numri i aktiviteteve të përbashkëta promovuese për segmentet e tregut	0	50	22%	12
--	--	---	----	-----	----

Sektori i ushqimit dhe përbërësve natyral

Në kuadër të këtij rezultati, projekti do të **vazhdojë të lehtësojë qasjen në kanalet e reja të shitjeve për NVM-të** si në tregun vendas ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Në vitin 2018, PPSE-ja ka lehtësuar pjesëmarrjen në panairët ndërkombëtare dhe misionet e shitjes me qëllim të qasjes në kanale të reja të shitjes. Veçanërisht e suksesshme ishte mbështetja e ofruar ndaj anëtarëve të ORGANIKA-s për pjesëmarrje në panairin Biofach, meqë rast NVM-të kanë regjistruar shitje me vlerë mbi 1 milion euro. Lehtësimi i misionit të shitjes është zbatuar nëpërmjet një bashkë-lehtësuesi zviceran (Triple E), i cili është dëshmuar të jetë i suksesshëm në tërheqjen e blerësve të mëdhenj zviceranë për produktet kosovare.

Duke marrë parasysh suksesin e aktiviteteve të lartpërmendura, në vitin 2019 PPSE-ja do të vazhdojë të ofrojë mbështetje për të njëjtat aktivitete. PPSE-ja do të shqyrtojë aktivitete shtesë në mbështetjen e NVM-ve për pjesëmarrje në panairë të tjera ndërkombëtare. Sa i përket qasjes në tregun e brendshëm, PPSE-ja planifikon të mbështesë hapësirat promovuese në dyqane të vogla (p.sh. restorantet, farmacitë) dhe promovimin përmes mediave për rritjen e ndërgjegjësimit për produkte cilësore vendore.

1. Përmes intervenimit **"Përkrahja e lidhjeve për pjesëmarrje në panairë tregtare"** projekti do të mbështesë **anëtarët e ORGANIKA-s për pjesëmarrje në panairin Biofach në vitin 2019**. Mbështetja për panairë të tjera ndërkombëtare do të shqyrtohet kryesisht brenda **shoqatave të sektorit**. Një mbështetje e tillë është siguruar gjithashtu në fund të vitit 2018, meqë rast shoqata e prodhuesve të frutave (SHKF) mori pjesë në panairin e mollës Interpoma në Itali. Qëllimi i këtij intervenimi është që të mundësojë krijimin e lidhjeve të reja të eksportit për NVM-të e Kosovës.
2. Përmes intervenimit **"Lehtësimi i shitjeve/misioneve të blerësve"**, projekti do të vazhdojë të punojë me Triple E, një kompani e specializuar për çiftëzim (ang. matchmaking) për tregun zviceran dhe gjerman. Kjo do të bëhet për të mundësuar që kompanitë vendore të **krijojnë partneritete afatgjata në nën-sektorë të ndryshëm**, veçanërisht duke synuar produkte të cilësisë së lartë, të tilla si produktet organike. Aktivitetet në kuadër të këtij intervenimi përfshijnë vizitat nga ana e NVM-ve të përzgjedhura të Kosovës për blerësit e huaj potencialë dhe vizita kthyesë të këtyre të fundit tek kompanitë e Kosovës me potencial për bashkëpunim të biznesit. Si rezultat i drejtpërdrejtë i aktiviteteve në kuadër të këtij intervenimi, një kompani zvicerane (Biopartner) ka nënshkruar një kontratë me Eurofrutin, ndërsa një vizitë tjetër e një blerësi të madh zviceran (Erboristi-Lendi) në ndërmarrjet e përzgjedhura të Kosovës pritet të ndodhë në fillim të vitit 2019.
3. Përmes intervenimit **"Promovimi i produkteve vendore në tregjet e brendshme"**, PPSE-ja planifikon të mbështesë NVM-të për të përmirësuar qasjen e prodhuesve vendor (kryesisht në shkallë të vogël) në tregun e brendshëm. Aktivitetet mbështetëse do të detajohen në bashkëpunim me grupet e prodhuesve të vegjël. Aktivitetet e mundshme përfshijnë vendosjen e hapësirave promovuese brenda kanaleve të synuara të shitjes (si: HoReCa), promovimin e përbashkët, promovimin përmes emisioneve televizive etj. Qëllimi i këtij intervenimi është rritja e shitjeve të prodhimeve vendore në Kosovë.

Sektori i turizmit

Qëllimi kryesor i intervenimeve nga ky rezultat është që t'i ndihmojë NVM-të e turizmit duke mundësuar dhe përmirësuar kanalet e shitjeve sipas segmenteve të tregut. Analizat dhe vëzhgimet e deritanishme të PPSE-së tregojnë se rritja më e madhe e mundshme në turizëm vjen nga segmentet e mëposhtëm: turistët vendorë dhe diaspora, turistët rajonal (veçanërisht nga Turqia dhe Shqipëria), turistët ndërkombëtarë që vizitojnë Ballkanin (kryesisht në turne ku përfshihen disa vende) dhe

turistët gjermano-folës për turizëm në natyrë dhe në qytet. Në vitin 2018, PPSE-ja ka mbështetur aktivitete të tilla si pjesëmarrja në panaire, udhëtime për familjarizim dhe gazetarë për të shënjestruar turistë aziatikë, dhe promovim të përshtatur përmes mediave të specializuara.

Në vitin 2019, PPSE-ja do të intensifikojë aktivitetet rreth segmenteve të tregut. Kjo nënkupton që PPSE-ja do të bashkëpunojë me shoqatat e turizmit dhe NVM-të për të synuar tregjet dhe turistët e segmenteve të identifikuar të tregut. Promovimi i ofertës turistike të Kosovës dhe lidhjet ndërmjet Kosovës dhe operatorëve ndërkombëtar të turizmit do të bëhet përmes aktiviteteve të tilla siç janë: lidhjet biznesore me tregjet burimore, pjesëmarrja në panaire, promovim të përshtatur dhe udhëtime për familjarizim. PPSE-ja synon përmirësimin e kanaleve të shitjes për të paktën 30 NVM dhe mbështetje për organizimin e së paku 5 aktiviteteve të përbashkëta promovuese për segmentet e tregut.

1. Sa i përket segmenteve **gjermano-folëse** (turistët nga Zvicra, Gjermania dhe Austria), PPSE-ja synon të angazhojë kompaninë zvicerane Triple E. Si rezultat i këtij intervenimi, PPSE-ja pret që të paktën **dy agjenci të mëdha të udhëtimit nga Zvicra të përfshijnë dhe promovojnë Kosovën** si pjesë të ofertës së tyre turistike. Kjo pastaj do të çojë në më shumë turistë zviceranë të cilët do të vizitojnë Kosovën për turizëm në natyrë dhe në qytet.
2. Për të promovuar Kosovën tek **turistët turq**, PPSE-ja do t'i mbështesë NVM-të përmes shoqatave të sektorit me pjesëmarrje në panairin EMMIT në Stamboll, në janar të vitit 2019, si dhe do të lehtësojë **lidhjet e drejtpërdrejta të biznesit në mes të operatorëve turistikë**. Potenciali dhe modalitetet e promovimit të Kosovës në tregun turk janë vlerësuar nga konsulentja Elita Alo, e cila zbuloi një numër të madh të turistëve të cilët vizitojnë vendet fqinje përmes turneve të organizuar edhe për qëllime të tilla siç janë turizmi kulturor dhe turizmi alternativ. PPSE-ja do të zbatojë aktivitetet pasuese (bazuar në gjetjet e vlerësimit) për të promovuar më tej ofertën turistike të Kosovës në tregun turk, nëpërmjet shkëmbimeve të drejtpërdrejta me agjencitë turke të udhëtimit.
3. PPSE-ja planifikon të mbështesë promovimin dhe shitjen e produkteve të turizmit tek **turistët vendorë dhe Diasporën** nëpërmjet prezantimit të një skeme me **kupona me vlerë**. Kjo do të realizohet përmes lidhjes së pronarëve të produkteve me kompanitë e telekomit (p.sh. kompania Vala). Kjo pritet t'i shtyjë kompanitë e telekomit që të promovojnë mbi 20 produkte të turizmit në Kosovë duke i ofruar këto produkte direkt tek klientët e tyre. PPSE-ja do të ndihmojë për dizajnimin/hartimin e pakos, koordinimin dhe promovimin e këtyre kuponëve. Kjo paraqet një mundësi që shënjestron mbi 1,000,000 turistë nga Diaspora.⁵
4. Aktivitetet specifike rreth segmentit të **turistëve të cilët vizitojnë rajonin** (turnetë në Ballkan) do të definohet në fillim të vitit 2019, sapo PPSE-ja të takohet me operatorët kryesor turistik ndërkombëtar në rajon të cilët ofrojnë shërbimin e turneve në Ballkan. PPSE-ja synon të mbështesë aktivitetet me qëllim të zgjatjes së qëndrimit në Kosovë dhe përfshirjen e Kosovës në 'pakot turistike për vizita në Ballkan'.
5. Në bashkëpunim me kompaninë Turkish Airlines në Kosovë dhe Butterfly Outdoors, PPSE-ja planifikon të eksplorojë tregje të reja të mundshme, siç është Skandinavia duke promovuar Kosovën në këto tregje dhe duke prezantuar ofertën e turizmit në Kosovë drejtpërdrejt tek operatorët turistikë të interesuar përmes udhëtimeve të familjarizimit dhe lidhjeve të biznesit.

Të arriturat 2.3: Palët e interesuara kanë përmirësuar organizimin e sektorit dhe rrjetëzimin

Uara kanë përmirësuar organizimin	Treguesi i të arriturve	Vlerësimi bazë 2017	Targeti për këtë fazë	% komulative e arritur në këtë fazë	2019 (T=Targeti)
-----------------------------------	-------------------------	---------------------	-----------------------	-------------------------------------	------------------

⁵ Numri i turistëve nga Diaspora të cilët e kanë vizituar Kosovën në vitin 2017 bazuar në Agjencinë e Statistikave të Kosovës.

	OP 2.3 Numri i iniciativave të përbashkëta për përmirësimin e rrjetëzimit dhe organizimin e sektorit rreth temave të përzgjedhura: menaxhimi i mbeturinave, segmentet e tregut, promovimi, koordinimi dhe shkëmbimi i njohurive	0	10	50%	3
--	---	---	----	-----	---

Sektori i ushqimit dhe përbërësve natyral

Sektori i ushqimit (në të gjithë zinxhirët e vlerës) është i shpërndarë dhe organizuar dobët. Në vitin 2018, ekipi ka bërë përpjekje të mëdha për të punuar në bashkëpunim me shoqatat sektoriale. Intervenime të suksesshme janë zbatuar me organizata të anëtarësimit të biznesit (së këndejmi BMO; ang. Business membership organisation) si ORGANIKA, Mjedra e Kosovës, SHTIB, SHKF, KMC, etj. Mbështetje specifike në lidhje me organizimin e sektorit i është ofruar SHTIB-it për organizimin e një vizite shkëmbyese në Shqipëri për të mësuar më shumë rreth praktikave të mira rajonale dhe KMC-së për organizimin e konventës së prodhuesve. Temat e sektorit, siç është ligji për tregtinë e brendshme, janë ndjekur nga afër, megjithatë ende nuk janë shënuar ndryshime të mëdha.

Në vitin 2019, PPSE-ja planifikon të **mbështesë organizimin e sektorit për temat që lidhen me skemat e subvencioneve dhe ndikimin në sektorin e bujqësisë dhe atë të përpunimit të ushqimit**. Kjo temë ka dalur në pah përmes konsultimeve me shoqatat e sektorit dhe konsiderohet si shumë e rëndësishme duke marrë parasysh ndryshimin dhe efektivitetin e modelit të subvencionimit të aplikuar në Kosovë kundrejt vendeve rajonale. Ekipi do të shqyrtojë gjithashtu çështjet lidhur me **përputhshmërinë e analizave laboratorike në Kosovë për produktet e eksportuara në tregjet e BE-së**.

1. Për të vlerësuar ndikimin e skemave të subvencioneve për bujqësinë dhe përpunimin e ushqimit në Kosovë, PPSE-ja do të mbështesë një studim krahasues mbi "**skemat e mbështetjes së subvencioneve**". Modelet aktuale të subvencionimit në Kosovë konsiderohen si më pak optimale nga shumë akterë të tregut. Praktikrat rajonale do të vlerësohen në mënyrë që të nxirren praktikat më të mira që të mund të aplikohen në Kosovë. Temat do të përfshijnë modelin e subvencionimit të të mbjellave në bazë të arritjeve kundrejt rezultateve, mbështetjes së eksportit etj. PPSE-ja synon t'i përdorë gjetjet përmes përfshirjes së BMO-së dhe organeve publike në mënyrë që të nxisë rritjen e sektorit të bujqësisë dhe sektorit të përpunimit të ushqimit.
2. Eksportuesit e Kosovës përballen me probleme të përputhshmërisë së dokumentacionit në lidhje me analizën e produktit (p.sh. fitosanitari). PPSE-ja do të shqyrtojë problemet e këtij fenomeni duke biseduar me organet përkatëse (p.sh. Institutin e Pejës). Për shkak të këtyre kufizimeve, eksportuesit e Kosovës janë të detyruar të bëjnë analiza shtesë për produktet e tyre nga organet e BE-së. Një vlerësim i brendshëm i shpejtë do të tregojë nëse ky problem mund të trajtohet përmes mbështetjes së PPSE-së.

Sektori i turizmit

PPSE-ja do të përcjellë dhe vazhdojë lehtësimin e aktiviteteve në kuadër të këtij produkti për të kontribuar në përmirësimin e koordinimit ndërmjet sektorit publik dhe atij privat dhe bashkëpunimin ndërmjet akterëve dhe shoqatave të sektorit privat. Në vitin 2018, PPSE-ja ka realizuar aktivitete rreth ligjit të turizmit, strategjisë të turizmit për komunën e Prishtinës dhe atë të Prizrenit dhe ka bërë një vlerësim lidhur me ndalimin e mundshëm të qeseve plastike në Kosovë. Në mënyrë të veçantë, PPSE-ja ka mbështetur MTI-në që të hartojë ligjin e turizmit duke angazhuar ekspertizë dhe duke siguruar përfshirjen e sektorit privat, ndërsa në Prizren dhe në Prishtinë është dhënë mbështetja përmes ekspertizës duke zbatuar metodologjinë SGDM. Si rezultat i menjëhershëm i strategjisë së turizmit, Komuna e Prishtinës, me mbështetjen e PPSE-së, ka ri-funksionalizuar pikat e informacionit të turizmit. Për më tepër, PPSE-ja do të iniciojë organizimin e një projekti rajonal të financuar nga SDC-ja që ka të

bëjë me zhvillimin e sektorit të turizmit në rajon. Ky do të jetë një hap fillestar që do të çonte në bashkëpunimin rajonal të palëve të interesuara kombëtare.

Në vitin 2019, PPSE-ja do të ndjekë zhvillimet lidhur me **ligjin mbi turizmin dhe zbatimin e strategjive të turizmit në Prishtinë dhe Prizren**. Mbështetje do të sigurohet për arritjen e një modeli të qëndrueshëm **për funksionimin e pikave të informacionit të turizmit në Prishtinë**. Për më tepër, aktivitete specifike do të mbështeten në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) për të mobilizuar akterët vendorë (prodhuesit e plastikës, zinxhirët e shitjes me pakicë, komunat etj.) për trajtimin e kësaj çështjeje duke gjetur modalitetet më të mira **për të reduktuar/ndaluar përdorimin e qeseve plastike - duke përdorur të gjeturat e vlerësimit**. Temat tjera të sektorit, **siç është ulja e TVSH-së për akomodime** do të shqyrtohet në bashkëpunim me shoqatat e sektorit. Aktivitetet e mëtejshme të koordinimit ndërmjet akterëve të sektorit privat do të organizohen në bazë të intervenimeve si: pjesëmarrja në panaire tregtare, zhvillimi i produkteve etj. Në përgjithësi, PPSE-ja synon të arrijë së paku dy iniciativa të përbashkëta në kuadër të këtij rezultati.

1. Lidhur me **reduktimin/ndalimin e përdorimit të qeseve plastike**, PPSE-ja ka ndarë gjetjet preliminare të vlerësimit me MMPH-në. Të gjeturat paraqesin tre modalitete kryesore për të ecur përpara siç janë: tatimi mbi qeset plastike, zëvendësimi i çantave jo bio-degraduese, ndalimi i qeseve plastike. Duke marrë parasysh gatishmërinë e zyrtarëve të MMPH-së, PPSE-ja do të mbështesë aktivitetet si p.sh. **tryeza të rumbullakëta për të koordinuar sektorin publik dhe atë privat në gjetjen e mënyrës më të mirë të përbashkët për këtë çështje**. Këto aktivitete pritet të fillojnë në muajin janar.

3.3 Të arriturat tjera

3.3.1 Fondi i mundësive

Në vitin 2018 dhe bazuar në vlerësimin dhe përvojën në Fazën e I-rë, Fondi i Mundësive (OF) vazhdoi të përdoret si një instrument shtesë për sektorët. Udhëzuesi operativ i fondit të mundësive është adaptuar në tremujorin e parë të vitit 2018 për të integruar më mirë OF-në brenda intervenimeve në sektor. Në vitin 2018, PPSE-ja ka pranuar 33 shprehje të interesit; 9 aplikantë kanë pasur mundësinë të zhvillonin koncept dokumentin dhe janë nënshkruar 3 marrëveshje bashkë-investimi sipas buxhetit të planifikuar për vitin 2018.

Në vitin 2019, PPSE-ja do t'i japë prioritet ndërhyrjeve të fondit të mundësive për sektorin e turizmit, me fokus të veçantë zhvillimin e produkteve të turizmit. Ekipi ka bërë përpjekje të mëdha për promovimin e zhvillimit të produkteve të turizmit duke u ofruar me biznese dhe komunën e Prishtinës dhe komunën e Prizrenit. Në fillim të vitit 2019, planifikohet të lansohet një thirrje për propozime për produkte të turizmit. Ekipi ka parë potencial për zhvillimin e produkteve të turizmit në rajonin e Prizrenit, ku NVM-të potenciale janë takuar kohët e fundit.

Në vitin 2019, PPSE-ja do të rishikojë udhëzuesin ekzistues me qëllim të integritit të mëtejshëm të proceseve të fondit të mundësive brenda strategjive sektoriale duke krijuar hapësirë dhe rol substancial për lehtësuesit e sektorëve për të identifikuar, kontraktuar dhe monitoruar intervenimet e fondit të mundësive. Përveç kësaj, ndryshimet e udhëzuesit synojnë të forcojnë kujdesin e duhur të bashkë-investimit të partnerëve.

3.3.2 Fondi për përfshirjen sociale

Fondi për përfshirjen sociale (ang. SIF – Social Inclusion Fund) është një instrument që mbështet krijimin e vendeve të punës në sektorin privat për komunitetet pakicë dhe grupet e tjera të përjashtuara shoqërore. Në vitin 2018, nëpërmjet fondit për përfshirjen sociale, PPSE-ja ka zbatuar pesë partneritete, me anë të tre intervenimeve: menaxhimin e mbeturinave, bio pelet dhe trajnimin e

kameriereve/kamerierëve si dhe dy vlerësime: një studim fizibiliteti për ndërmarrjen shoqërore TOKA dhe një vlerësim për stereotipat gjinore për zgjedhjet arsimore, të bëra në bashkëpunim me projektin EYE.

Në vitin 2019, fondi për përfshirjen sociale do të vijoj të punoj mbi intervenimin në lidhje me menaxhimin e mbeturinave në komunën e Graçanicës, ku komuniteti RAE ishte në shënjestër. Intervenimi në lidhje me prodhimin e bio-peletit është nënshkruar kah fundi i vitit 2018. Ky intervenim do të zbatohet në vitin 2019 dhe synon të rrisë kapacitetin prodhues dhe cilësinë e prodhimit të peletit në Novobërdë. Për më tepër, PPSE-ja do të shqyrtojë me kujdes përmes SIF-it kërkesat individuale që vijnë nga komuniteti RAE, veçanërisht ato që bashkëplotësojnë aktivitetet dhe fushat sektoriale të intervenimit. SIF do të shfrytëzojë aktivitetet e saj përmes granteve tipike, si dhe intervenimeve të cilat synojnë një ndryshim më të gjerë të sistemit për grupet e përjashtuara shoqërore, duke përfshirë këtu gratë dhe pakicat e tjera. Prioritet do t'i kushtohet mundësive për krijimin e vendeve të punës dhe gjenerimin e të ardhurave për popullatën e pa favorizuar. Për më tepër, SIF-i do të kërkojë mundësi të të bërit biznes në mes të serbëve të Kosovës të cilët do të mbështesin rritjen e kapaciteteve të biznesit dhe depërtimin në treg të produkteve dhe shërbimeve të caktuara.

4. Temat transversale

Përfshirja Sociale

Përveç shfrytëzimit të fondit për përfshirjen sociale përmes të cilit ne synojmë popullsinë dhe grupet e pa favorizuara, kryesisht komuniteti RAE, PPSE-ja do të vazhdojë të dizajnojë intervenime duke u fokusuar në sektorë, pra në zonat e pakicave ose me partnerë gra, si dhe të përfshijë aktivitetet në nënsektorë të veçantë të cilët kanë potencial të lartë për përfshirje. Shembuj të suksesshëm të përfshirjes së përgjithshme dhe ndërhyrjeve të shënjestruara në vitin 2018 përfshijnë: bujqësinë e kontraktuar, biznesin Peppermint përmes OF-së, dhe trajnimin e kamerierëve/kamariereve përmes SIF-it. Në kuadër të kontraktimit të bujqësisë kontraktuese, rreth 29% e punëtorëve të angazhuar shtesë nga fermerët i përkasin komunitetit RAE.

Një partneritet është kryer me një biznes serb (përmes bujqësisë kontraktuese si dhe përmes OF-së) i cili ka kontraktuar 26 fermerë serbë dhe boshnjakë. Për më tepër, rreth 40 serbë të rinj nga zonat rurale janë trajnuar për profesionin e mikpritjes përmes një trajnimi afatshkurtër të mbështetur nga PPSE-ja.

Për vitin 2019, PPSE-ja do të synojë të sigurojë përfshirjen përmes intervenimeve dhe aktiviteteve të mëposhtme:

- Nën kuadër të sektorit të turizmit, PPSE-ja do të shqyrtojë mundësinë e përfshirjes së bizneseve të pakicave duke shënjestruar segmente të turistëve rajonal, me fokus të veçantë tek turistët nga Serbia. Kjo mund të përfshijë aktivitete të tilla si: udhëtime familjare, pjesëmarrje në panairë etj. Për më tepër, mundësitë për zhvillimin e produkteve të turizmit do të kërkohen në bashkëpunim me sektorin privat të pakicave në Graçanicë, Shtërpçë, Novobërdë, Zubin Potok, dhe/ose Leposaviq.
- Në kuadër të sektorit të FNI-së, PPSE-ja do të vazhdojë të përfshijë minoritetet në kuadër të intervenimit për ferma të kontraktuara, veçanërisht në sektorin MAP-së. Përveç kësaj, projekti do të shqyrtojë mundësitë për të krijuar lidhje biznesi dhe kanale të reja të shitjes për produktet e ofruara nga bizneset që drejtohen nga grupe të përjashtuara shoqërore. Poashtu, bizneset e drejtuara nga pakicat do të shënjestrohen përmes OF-së, veçanërisht duke u fokusuar në rritjen e kapaciteteve të tyre të prodhimit dhe të përpunimit.

Gjinia

Nëpërmjet ndërhyrjeve të PPSE-së të zbatuara në vitin 2018, barazia gjinore dhe fuqizimi ekonomik i grave është integruar përgjatë intervenimeve të sektorëve. Në mënyrë të veçantë, në sektorin e FNI-së, gratë ishin të mirë përfaqësuara si fuqi punëtore deri në 40% të punësimit të përgjithshëm të gjeneruar. Brenda sektorit të FNI-së, 7 nga 19 partneritete me PPSE-në ishin me bizneset në pronësi të grave dhe 90 nga 209 fermerë të kontraktuar ishin gra. Në sektorin e turizmit, gjashtë prej dymbëdhjetë udhëzuesve të trajnuar të qytetit ishin gra.

PPSE-ja synon të arrijë të gjitha synimet për përfshirjen e grave nëpërmjet intervenimeve në FNI dhe në sektorë të turizmit në vitin 2019. Përpjekje të veçanta do të bëhen për përfshirjen e grave përgjatë intervenimeve në të dy sektorët, si dhe në fuqizimin e grave me aktivitete të synuara. Një seminar mbi aktivitetet e planifikimit dhe intervenimet për integrimin gjinor është organizuar në dhjetor me mbështetjen e specialistit gjinor të Swisscontact-it.

Në sektorin e FNI-së, do të vazhdojnë përpjekjet për të përfshirë fermeret gra përmes intervenimit "ferma të kontraktuara" (si fermerë dhe si punonjës, poashtu). Aktivitete të ndara do të jenë pjesë e së njëjtit intervenim në mënyrë që drejtpërdrejt të sigurojnë informata të duhura dhe shërbime trajnuese për gratë. Përveç kësaj, mbështetja specifike (të nxitura nga mundësitë) për gratë sipërmarrëse në sektorin e ëmbëlsirave, do të merret në konsideratë, veçanërisht nëpërmjet rezulttit 1.1, dhe do të ndikojë drejtpërdrejt në bizneset e grave, meqenëse shumica e bizneseve në këtë sektor janë në pronësi të grave. Përveç kësaj, bizneset e grave do të mbështeten dhe priorizohen për aktivitetet e pjesëmarrjes në panaire.

Projekti do të vazhdojë të përfshijë gratë në të gjithë aktivitetet në të dy sektorët. Në sektorin e turizmit do të pilotohen aktivitetet që përmirësojnë furnizimin me ushqim për turizmin, në të cilën PPSE-ja do t'i japë përparësi familjeve të udhëhequra apo të dominuara nga gratë për ofrim të mbështetjes. Intervenime të tjera në turizëm, ku do t'u jepet prioritet punësimit të grave, do të jenë në "profesionet e specializuara të turizmit" (p.sh. udhërrëfyesit/guidat, kamarieret, kuzhinieret etj.) si dhe për "zhvillimin e produkteve të turizmit".

7.2.2. Monitorimi dhe matja e rezultateve

PPSE do të vazhdojë të monitorojë të gjitha intervenimet që janë në vijim e sipër, duke përditësuar hallkat e rezultateve, planet e monitorimit dhe mbledhjen e të dhënave më cilësore për të drejtuar intervenimet. Standardi DCED-së dhe udhëzuesi i Swisscontact-it për MRM do të vazhdojnë të përdoren për matjen e rezultateve dhe sistemin e monitorimit të PPSE-së. Ekipi do të përdorë të dhënat e vazhdueshme të monitorimit nga vizitat e shpeshta në terren dhe do të ndryshojë planet e intervenimit për përmirësimin e modeleve biznesore.

Në vitin 2018, ekipi ka punuar gjerësisht për të përfunduar dokumentet e MRM-së për të gjitha intervenimet që janë në vijim e sipër. Në këtë drejtim, ekipi ka zhvilluar dy zinxhirë të rezultateve të sektorit si dhe dokumente të MRM-së (koncept dokumente, zinxhirë të rezultateve, plane monitorimi dhe intervenimi) për të gjitha intervenimet në vijim e sipër në sektorin FNI dhe atë të turizmit. Janë kryer dy vlerësime të gjera, njëra nga anketat e anës së ofertës turistike dhe tjetra për vlerësimin e ndikimit të intervenimeve në bujqësi. Të dy vlerësimet u menaxhuan nga projekti përmes angazhimit të anketuesve dhe konsulentëve (për anketën e ofertës së turizmit), me një mostër prej 468 NVM-ve për anketën e ofertës së turizmit dhe 211 fermerë për vlerësimin e ndikimit të bujqësisë kontraktuese. Një arritje e rëndësishme për PPSE-në në vitin 2018 ishte prezantimi i matësve të përafërt të punësimit dhe metodologjia e shumëzimit të përdorura nga PPSE-ja në ngjarjen vjetore të BEED DCED.

Në vitin 2019, ekipi do të përditësoj dhe përgatisë dokumentin e lidhur me MRM-në për intervenimet që janë në vijim e sipër si dhe për intervenimet e reja. Për më tepër, rezultatet nga vlerësimet e intervenimeve dhe monitorimi do të shfrytëzohen në bashkëpunim me menaxhmentin për të drejtuar

dhe për të vendosur për intervenimet tjera. Disa vlerësime janë planifikuar për të përmirësuar monitorimin dhe drejtimin e PPSE-së. Fillimisht, anketa e anës së ofertës turistike do të kryhet përsëri për Kosovën në mënyrë që të kapë ndryshimet e sektorit për vitin 2018.

Janë planifikuar vlerësimet e intervenimit të bujqësisë kontraktuese (deri në fund të vitit 2019) dhe intervenimet e turizmit në lidhje me matjen e ndikimit që mund t'i atribuohet turistëve shtesë ndërkombëtarë. Ky vlerësim, krahas vlerësimit të ofertës së turizmit, do t'i mundësojë ekipit të shfrytëzohet matës të përafërt të punësimit të turizmit dhe metodologjinë shumëzuese për llogaritjen e punësimit dhe ndikimin në të ardhurat e sektorit të turizmit. Ndërsa për ndërhyrje specifike (p.sh. zhvillimi i produktit), ekipi do të vazhdojë të kryejë vlerësime një-me-një me përfuturit.

Për të përmirësuar sistemin e monitorimit, raportimit dhe drejtimit, ekipet planifikojnë të kontraktojnë dy vlerësime të reja, një në lidhje me ndikimin indirekt të bujqësisë (multiplikatorët) dhe një tjetër në lidhje me ndikimin e përdorimit të fidanëve të specializuar në prodhimin dhe cilësinë e produkteve bujqësore.

7.3 Komunikimi

Në vitin 2019, PPSE do të përpiqet që të komunikojë lidhur me ndikimin. Strategjia dhe aktivitetet e komunikimit do të tregojnë një ekuilibër të shëndoshë ndërmjet "komunikimit institucional" (dmth. Informimi i publikut për punën e SDC-së dhe PPSE-së, përkrahja e dukshmërisë së agjencisë dhe projektit dhe kultivimi i mëtejshëm i marrëdhënieve publike) dhe "komunikimi për zhvillim - C4D" (p.sh. lehtësimi i qasjes në informata, stimulimi i pjesëmarrjes dhe ndihma për njerëzit e pushtetit, dhe përpjekja për të ndikuar). Mesazhi kryesor do të sillet rreth kontributit të Qeverisë Zvicerane për zhvillimin e sektorit privat dhe krijimin e vendeve të punës në Kosovë, me qëllim që të ndikojë në ndryshimet ekonomike dhe sociale përmes mesazheve të hartuara në mënyrë të duhur dhe përmbytjes mbështetëse. Në mënyrë që sa më shumë të zhvillohet në konceptin e komunikimit për zhvillim, këtë vit PPSE-ja do të përdorë tregimin transformues për të paraqitur rezultatet e arritura nëpërmjet tregimeve të "personazheve me agjenci", në mënyrë që të ndihmojë në përqendrimin më të madh të audiencës dhe të përcjellë informacione nëpërmjet përvojave njerëzore, për të dhënë mesazhin se ndryshimi është i mundur dhe i motivon njerëzit të veprojnë.

Natyra dhe intensiteti i përpjekjeve të komunikimit do të mbështeten kryesisht në aktivitetet e ndërhyrjes dhe rezultatet e secilit sektor. Materialet e komunikimit do të mbështesin nevojat e sektorit, të përshtatura për audiencat kyçe të identifikuar, të përcjella përmes një sërë kanalesh dhe mjeteve komunikimi: mediat sociale, faqja e projektit, artikujt e vendosur me media (online dhe tradicionale), buletini i projektit, video dhe të tjera. Këtë vit, PPSE do të hapë një faqe në Instagram për të plotësuar më tej prezencën në mediat sociale dhe për tu drejtuar tek audiencat më të reja që përdorin kryesisht këtë kanal.

Specialisti i marrëdhënieve me publikun dhe komunikimit do të bashkëpunojë me anëtarët e ekipit dhe do të ofrojë këshilla ose mbështetje sipas nevojës për partnerët e projektit në përpjekjet e tyre për të komunikuar rezultatet përmes ngjarjeve ose materialeve promovuese. Në vijim të organizimit të suksesshëm të Ditës Ndërkombëtare të Tokës më 22 prill 2018, që u shndërrua në një ngjarje të mbështetur nga komuna e Prishtinës, këtë vit, ngjarja do të organizohet së bashku me SIF në komunën e Graçanicës; për të gjeneruar më shumë dukshmëri për riciklimin dhe aktivitete për krijimin e vendeve të punës për romët në këtë zonë dhe shfrytëzohet mundësinë për ngritjen e vetëdijes me potencialin që të fillojë ndryshimin e sjelljes në një shkallë më të gjerë. Aktivitete të tjera të shtyra nga komunikimi në mbështetje të qëllimeve të projektit, do të fokusohen drejt vënies në pah të integritimit gjinor, krijimin e vendeve të punës për gratë dhe grupet e tjera të përjashtuara nga shoqëria, si dhe shqetësimet mjedisore, ndër të tjera.